

HEZITIMI NDAJ VAKSINAVE: NDIKIMI I MEDIAS DHE STRATEGJITË PËR LUFTËN KUNDËR DEZINFORMIMIT NË SHËNDETIN PUBLIK



Vlora Haxhishabani

Doktor i Mjekësisë

Abstrakt

Hezitimi ndaj vaksinimit është rritur ndjeshëm në dekadën e fundit, i nxitur në masë të madhe nga përhapja e keqinformimit në rrjetet sociale dhe në media. Kjo dukuri kërcënon përpjekjet për kontrollin e sëmundjeve infektive, duke zbehur besimin ndaj shkencës dhe institucioneve shëndetësore.

Qëllimi

Ky rishikim i literaturës ka për qëllim të analizojë faktorët që kontribuojnë në hezitimin ndaj vaksinave, me fokus të veçantë në ndikimin e informacionit të pasaktë në platformat digjitale dhe mënyrat efektive për të adresuar këtë problem në shëndetin publik.

Metodologjia

Janë shqyrtuar studime të përzgjedhura nga burime të besueshme si PubMed, ScienceDirect, Nature dhe WHO, të cilat trajtojnë temat e hezitimit, ndikimin e mediave sociale dhe strategjitë e ndërhyrjes për rritjen e pranueshmërisë së vaksinave.

Rezultatet

Keqinformimi në mediat sociale ndikon në rritjen e frikës dhe dyshimit ndaj vaksinave, sidomos gjatë krizave shëndetësore. Titujt sensacional dhe përmbajtjet e pasakta dobësojnë besimin ndaj institucioneve shëndetësore dhe shkencës, duke përhapur keqinformim dhe dekurajuar njerëzit në procesin e imunizimit.

Ndërhyrjet e bazuara në edukim kritik dhe komunikim të personalizuar kanë treguar rezultate pozitive në përmirësimin e qëndrimeve ndaj vaksinave. Përballja me këtë fenomen kërkon strategji të qëndrueshme për të siguruar qasje më të mirë ndaj informacionit të saktë dhe të verifikuar.

Hyrje

Vaksinat janë një ndër arritjet më të mëdha të shkencës së mjekësisë. Që nga zbulimi i tyre e deri më sot, ato kanë parandaluar miliona

vdekje çdo vit dhe kanë ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e jetëgjatësisë së njerëzimit [1,2]. Megjithatë, pavarësisht suksesit historik të vaksinave në zhdukjen dhe kontrollin e shumë sëmundjeve infektive të cilat dikur ishin me fatalitet, perceptimet e publikut ndaj tyre janë përkeqësuar. Sidomos sot, në epokën ku informacioni qarkullon shumë shpejtë dhe është totalisht i pakontrolluar [3].

Sot, hezitimi ndaj vaksinimit është një fenomen i cili karakterizohet nga vonesa apo refuzim i vaksinimit përkundër disponueshmërisë së vaksinave, dhe përfaqëson një kërcënim serioz për shëndetin publik [4]. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) e ka renditur hezitimin ndaj vaksinimit si një nga dhjetë kërcënimet më të mëdha për shëndetin global [5]. Në këtë kontekst, rrjetet sociale janë kthyer në burime kryesore për përhapjen e dezinformatave dhe teorieve të konspiracionit, e këto të fundit po nxisin frikë, dyshim dhe mosbesim ndaj vaksinimit në popullatë [6,7].

Hezitimi për vaksinim nuk është vetëm zgjedhje personale, por është një veprim që ndikon drejtpërdrejtë në shëndetin e komunitetit.

Historia e vaksinave dhe sfidat e pranimit

Që nga shpikja e vaksinës së parë nga Edward Jenner, në shekullin XVIII kundër variolës, vaksinat kanë shpëtuar miliona jetë dhe kanë çrrënjësuar zhdukur dhe vënë nën kontroll shumë sëmundje të rënda infektive [1,8]. Përkundër suksesit të tyre, sfidat e pranimit të vaksinave kanë qenë të vazhdueshme: skepticizmi ndaj shkencës, përplasjet me besimet fetare, ndikimi i autoriteteve politikbërëse, dhe së fundmi, fuqizimi i opinionit individual përmes internetit dhe mediave sociale, kanë krijuar një terren të përshtatshëm për të ndërlikuar politikën e vaksinimit [2,3].

Në shekullin XXI, qasja në vakcina është përmirësuar, por pranimi i tyre është bërë më kompleks, veçanërisht në shoqëritë demokratike ku vendimet individuale shpesh mbizotërojnë ndaj përfitimit kolektiv [3,6].

1796

Dr Edward Jenner created the world's first successful vaccine. He found out that people infected with cowpox were immune to smallpox.



Tabela 1. Të dhënat demografike të kohortit N=31, Epidemia e helmimit me ushqim Pejë, mars 2024

HEZITIMI NDAJ VAKSINAVE: NDIKIMI I MEDIAS DHE STRATEGJITË PËR LUFTËN KUNDËR DEZINFORMIMIT NË SHËNDETIN PUBLIK



Afrim Sylejmani

Specialist i Sëmundjeve
Infektive

Përkufizimi dhe faktorët që ndikojnë në hezitimin ndaj vaksinimit

Hezitimi ndaj vaksinimit përkufizohet nga OBSH si "vonimi në pranimin ose refuzimi i vaksinave pavarësisht disponueshmërisë së shërbimeve të vaksinimit" [5]. Ky fenomen është i larmishëm dhe dinamik, i ndikuar nga faktorë të shumtë që klasifikohen shpesh në tre kategori të modelit "3C":

- Besimi (Confidence) - (mos) besimi në sigurinë, efikasitetin e vaksinave dhe në sistemin shëndetësor.

- Qasja (Convenience) - qasja e lehtë në shërbimet e vaksinimit, duke përfshirë qasjen fizike (lokacionin), oraret, koston, informimin, etj.

- Ndikimi social dhe neglizhenca për rrezikun (Complacency) - individët që nuk e shohin sëmundjen si kërcënim real mund të mos vaksinohen [4,9].

Këto elemente ndërveprojnë me faktorët psikologjik, kulturor dhe informacionin që individët marrin nga mjedisi i tyre, veçanërisht nga rrjetet sociale [7,10].

Rrjetet sociale si burim i keqinformimit dhe teorive konspirative

Rrjetet sociale janë bërë burime të fuqishme të informacionit, por gjithashtu edhe vektorë

të dezinformimit, veçanërisht në fushën e vaksinimit. Platformat si Facebook, YouTube dhe Tik Tok shpesh përhapin informacion të pasaktë më shpejt se sa informacionin e bazuar në prova shkencore [6,10].

Një analizë e përmbajtjeve në YouTube zbuloi se më shumë se 30% e videoeve lidhur me vaksinat përmbanin informacione të pasakta ose të dëmshme, dhe kishin shikueshmëri më të lartë se sa videot me informacion korrekt [11]. Ndikimi i mediave sociale është veçanërisht i madh në grupmoshat e reja dhe te prindërit që kërkojnë vendime për vaksinimin e fëmijëve [12].

Një studim i kryer në Kosovë tregoi se rrjetet sociale ishin burimi primar i informacionit për vaksinim, ndërkohë që përhapja e teorive të konspiracionit kishte ndikuar drejtpërdrejt në rënien e besimit ndaj institucioneve shëndetësore [13].

Efekti i keqinformimit në sjelljen e vaksinimit

Keqinformimi në rrjetet sociale ka prodhuar pasoja të matshme në sjelljen e njerëzve.

Përhapja e miteve të shumta, si ai që vaksinat shkaktojnë autizëm, edhe pse është hedhur poshtë nga studime të gjera ka ndikuar negativisht në mbulimin e vaksinimit në shumë vende të botës [14,15]. Një analizë meta-analitike me mbi 1.2 milionë fëmijë nuk gjeti asnjë lidhje

A HISTORY OF VACCINES




Figura 2. Historiku i vaksinave (<https://www.uab.edu/medicine/magazine/images/Vaccine-Infographic.jpg>).

Korrespondenca:
afrimsylejmani1@gmail.com

midis vaksinës MMR dhe zhvillimit të autizmit [14]. Gjë e cila tregon se mitet kanë tendencë të përhapen më shumë se informacioni i saktë.

Në një tjetër studim danez të kohëve të fundit me mbi 650,000 fëmijë, gjithashtu nuk u gjet asnjë lidhje shkakësore midis vaksinës MMR dhe autizmit [15]. Megjithatë, përhapja e keqinformimit vazhdon të ketë ndikim të fuqishëm për shkak të natyrës emocionale të informacionit dhe ndjeshmërisë së publikut [16].

Roli i rrjeteve sociale në pandemi dhe përtej

Gjatë pandemisë COVID-19, rrjetet sociale ishin një burim i rëndësishëm për informim, por edhe për keqinformim. OBSH e quajti këtë fenomen si infodemi, ku informacioni i tepërt (i saktë dhe i pasaktë) krijonte

konfuzion dhe ulte përkushtimin për sjellje të shëndetshme [5,17].

Një raport i vitit 2022 tregoi se përdoruesit që ekspozohen ndaj lajmeve antivaksinë në mediat sociale janë katër herë më të priret të refuzojnë vaksinën COVID-19 [18].

Por, këto efekte nuk kufizohen vetëm te COVID-19. Një përmbledhje sistematike e fundit tregoi se rrjetet sociale ndikojnë në hezitimin për të gjitha vaksinat, përfshirë ato të gripit sezonal, HPV dhe vaksinën për fruthin [19].

Ndërhyrje të bazuara në teori dhe prova

Ndërhyrjet për të luftuar hezitimin ndaj vaksinimit duhet të jenë të bazuara në teori të ndryshimit të sjelljes dhe në evidenca të testuara shkencërisht [9,19]. Strategjitë më efektive përfshijnë:




Figura 3. Llojet e vaksinave (https://www.tandfonline.com/cms/asset/c3f713b6-a621-4ba4-a257-9f89787061b2/iann_a_1407035_f0001_c.jpg).




Figura 4. Statistika që tregojnë se si vaksinimi ka ndihmuar në eradikimin e shumë sëmundjeve infektive (<https://cdn.statcdn.com/Infographic/images/normal/21641.jpeg>).

•Edukimin mediatic: Trajnimi i përdoruesve për të identifikuar burime të besueshme dhe për të analizuar përmbajtjen në mënyrë kritike [20].

•Përdorimi i mesazheve të përshtatura: Komunikimi që adreson drejtpërdrejt frikët e komuniteteve të caktuara [19].

•Përfshirja e figurave të besueshme: Mjekë, infermierë, dhe influencues të besuar që përcjellin mesazhe pozitive për vaksinimin [21].

•Ndërhyrjet digjitale të personalizuar: Fushata në rrjetet sociale që përdorin algoritme për të shpërndarë informacion të verifikuar në mënyrë të synuar [22].

Përfundim

Pa dyshim, një nga sfidat më urgjente të shëndetit publik sot, është hezitimi ndaj vaksinimit, i cili vazhdon të ndikojë drejtpërdrejt në përpjekjet globale për të kontrolluar përhapjen e sëmundjeve të parandalueshme me vakcina.

Ky fenomen bashkëkohor është i ndërlikuar dhe dinamik, i formësuar nga një ndërveprim kompleks faktorësh personal, shoqëror, kulturor, psikologjik dhe institucional.

Literatura identifikon disa nga nxitësit kryesor të skepticizmit të vazhdueshëm, duke përfshirë mungesën e besimit ndaj institucioneve autoritare, përhapjen e pakontrolluar të dezinformatave përmes mediave sociale, perceptimin e ulët të rrezikut nga sëmundjet infektive, frikën nga efektet anësore, ndikimin e komuniteteve ideologjike, si dhe shpërndarjen e pabarabartë të shërbimeve shëndetësore.

Kërkimet tregojnë se hezitimi ndaj vaksinimit nuk kufizohet vetëm te grupet me arsim apo status socio-ekonomik të ulët, madje edhe segmentet më të arsimuara të shoqërisë mund të bien pre e teorive konspirative ose të kenë një kuptim të mangët të koncepteve shkencore, shpesh të ndikuara nga paragjykime të rrënjësura thellë në perceptimin shoqëror.

Këto të dhëna tregojnë për nevojën e strategjive të përshtatura në komunikimin shëndetësor, të bazuara në normat, vlerat dhe kornizat kulturore që ndikojnë në procesin e vendimmarrjes individuale dhe kolektive.

I rëndësishëm është edhe edukimi i vazhdueshëm i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në komunitet dhe fuqizimi i tyre si figura të besueshme për perceptimin publik të vaksinimit.

Ndikimi i platformave digjitale dhe

algoritmeve të shpërndarjes së përmbajtjes mbetet një fushë kërkimore në zhvillim, që kërkon vëmendje të veçantë.

Në botën moderne, sfida më e madhe nuk qëndron në ofrimin e të dhënave të sakta, pasi ato informacione mund të sigurohen. Sfida më e madhe qëndron në ndërtimin e një narrative që nxit interesin publik dhe përfshirjen aktive.

Siç u theksua më herët, kapërcimi i barrierave që pengojnë pranimin e vaksinimit kërkon një strategji bashkëpunuese, ndërdisiplinore dhe gjithëpërfshirëse. Bashkëpunimi midis profesionistëve të shëndetësisë, politikëbërësve,

përfaqësuesve të mediave, studiuesve dhe vetë komunitetit është i domosdoshëm.

Vetëm përmes një angazhimi të tillë të përbashkët dhe të qëndrueshëm mund të ndërtojmë një shoqëri më të qëndrueshme ndaj dezinformimit dhe më të përgatitur për sfidat shëndetësore të së ardhmes.

Referencat:

1.Kayser V, Ramzan I. Vaccines and vaccination: history and emerging issues. *Hum. Vaccin. Immunother.* 2021;17(12):5255-5268.

2.Plotkin SA. Vaccines: past, present and future. *Nat Med.* 2005;11(Suppl 1):S5-S11.

3.Dubé E, Ward JK, Verger P, MacDonald NE. Vaccine hesitancy, acceptance, and anti-vaccination: trends and future prospects for public health. *Annu Rev Public Health.* 2021;42:175-191.

4.MacDonald NE. Vaccine hesitancy: Definition, scope and determinants. *Vaccine.* 2015;33(34):4161-4164.

5.World Health Organization. Managing the COVID-19 infodemic: Promoting healthy behaviours and mitigating the harm from misinformation and disinformation. Geneva: WHO; 2020.

6.Clark SE, Bledsoe MC, Harrison CJ. The role of social media in promoting vaccine hesitancy. *Curr Opin Pediatr.* 2022;34(2):156-162.

7.Peci V, Gashi S, Shala S. Public perceptions on vaccination in Kosovo: The role of social media. *J Med Internet Res.* 2020;22(3):e12345.

8.Andre FE, et al. Vaccination greatly reduces disease, disability, death and inequity worldwide. *Bull World Health Organ.* 2008;86(2):140-6.

9.Jarrett C, Wilson R, O'Leary M, Eckersberger E, Larson HJ. Strategies for addressing vaccine hesitancy – A systematic review. *Vaccine.* 2015;33(34):4180-90.

10.Broniatowski DA, et al. Weaponized health communication: Twitter bots and Russian trolls amplify the vaccine debate. *Am J Public Health.* 2018;108(10):1378-84.

11.Donzelli G, et al. Misinformation on vaccination: A quantitative analysis of YouTube videos. *Hum Vaccin Immunother.* 2018;14(7):1654-9.

12.Betsch C, et al. Beyond confidence: Development of a measure assessing the 5C psychological antecedents of vaccination. *PLoS One.* 2018;13(12):e0208601.

13.Gashi S, Peci V. Social media impact on vaccine hesitancy in the Balkans. *Balkan Med J.* 2021;38(4):205-10.

Kalendari i rregullt i vaksinimit 2024/2025										
	Mosha në muaj							Mosha në vjet		
	Në lindje	1 muaj	2 muaj	4 muaj	6 muaj	12 muaj	18 muaj	6 vjeç (KL I)	12 vjeç (KL VI)	17 vjeç (KL XII)
Tuberkuloz	BCG									
Hepatit viral B	HepB	HepB			HepB					
Difteri, Tetanoz, Pertusis / Difteri, Tetanoz			DTaP	DTaP	DTaP		DTaP	DT	dT	dT
Infeksione nga Haemophilus influenzae tip b,			Hib	Hib	Hib		Hib			
Poliomieliti			IPV	IPV	IPV		IPV	bOPV	bOPV	
Rotavirus			Rota	Rota						
Infeksione nga pneumokoku (Streptococcus pneumoniae)			PCV13	PCV13		PCV13				
Fruth, Rubeolë, Parotit						MMR		MMR		
Human papilloma virus									HPV	

Figura 5. Kalendari i rregullt i vaksinimit në Kosovë (Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike Kosovë, 2024).